

# **“GIULIA” SHPK**

## **AKT THEMELIMI**

**PËR**

**SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

Themeluesi ka vendosur të krijojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sot më datë 07.01.2025 në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në bazë të kushteve që vijnë;

*Themeluesit:*

1. Zhulieta Harasani, atësia Besim, lindur në Tiranë, më datë 05.04.1968, dhe banues në adresën Njësia Administrative Nr. 9, Rruga “Cerciz Topulli”, Pallati Evisa Konstruksion, Kati 5, Tiranë, Shqipëri, me ID G85405074E dhe Nr. I dokumentit të Identifikimit 035620775

### *NENI 1*

Zhulieta Harasani, do të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilën do ta quajë: “Giulia” Sh.p.k., e cila do të ketë si objekt:

Ne fushen e turizmit, HORECA dhe ekonomine e kujdesit, hapja dhe menaxhimi i hoteleve, godinave dhe ambienteve ne te cilat ushtrohet aktivitet qe lidhet me fushat e siperpermendura.Hapja dhe menaxhimi i sallave te konferencave, i qendrave te rekreacionit, me ose pa profil te dermo-estetikes, trajtimit te lekures dhe trupit, per masazhe. spa, mirembajtje trupore, fitness, pishina, udhetime turistike etj.

Ne fushen e qiradhenies se zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive te tjera te paluajtshme qe i perkasin hotelitGiulia Sh.p.k. Kryerja e tregtimit, prodhimit dhe perpunimit te mallrave qe kane te bejne me aktivitetin e hotelerise, horeca dhe ekonomise se kujdesit. Hapja e menaxhimi i bareve. Realizimin e kontratave, marrëveshjeve, ortakërive shoqërive të përbashkëta apo formave të tjera të lejuara nga legjilacioni shqiptar, me persona fizikë dhe juridikë, shqiptar ose të huaj, për të realizuar operacione tregtare dhe veprimtari të ndryshme që janë të nevojshme dhe me interes për shoqërinë si dhe për çdo lloj aktiviteti që do ti shërbeje realizimit të objektit. Gjithashtu shoqëria mund të ushtroje edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur më sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim si dhe të dobishme për arritjen e objektivave të

saj kryesore. Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona fizikë, juridikë, me çdo shoqëri tjetër, brenda dhe jashtë vendit.

#### *NENI 2*

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Shqipëri në adresën :

“Njësia Administrative Nr. 9, Rruga e Barrikadave, Zona Kadastrale 8360 , godina me Numer Pasurie 6/84/ND, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### *NENI 3*

**KOHËZGJATJA** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

#### *NENI 4*

**KAPITALI THEMELTAR** i shoqërisë është 10,000 lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga “ortakët” e shoqërisë :

- 1- Zhulieta HARASANI, zotërues i 1 kuote, me vlerë nominale 10,000 lekë dhe me vlerë të përgjithshme 10,000 lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

#### *NENI 5*

Administrator i shoqërisë do të jetë:

Zhulieta Harasani, atësia Besim, lindur në Tiranë, më datë 05.04.1968, dhe banues në adresën Njësia Administrative Nr. 9, Rruga “Cerciz Topulli”, Pallati Evisa Konstruksion, Kati 5, Tiranë, Shqipëri, me ID G85405074E dhe Nr. I dokumentit të Identifikimit 035620775, emëruar në këtë detyrë për një afat **5 vjeçar** me të drejtë ripërtëritje.

*NENI 6*

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij Akt Themelimi, edhe me norma të përcaktuara në një Statut, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të fitojë personalitetin juridik me regjistrim në “Qendrën Kombëtare të Biznesit” në bazë të Ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar, ditën kur shoqëria do të legalizohet si person juridik shqiptar.

**ORTAKËT E SHOQËRISË**

**“GIULIA” SHPK**

**ZHULIETA HARASANI**

*Zhuljeta Harasani*  
